



BASHKIA FIER



Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese"; Tel/Fax : 034 410 636

Nr. 838 Prot.

Fier, më 12.12.2016

Lënda : Dergimi i dokumentacionit per kontraten "Ripertertije urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi"

Drejtuar : DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE PUNEVE PUBLIKE
KETU

Ne perfundim te procedurave te prokurimit me objekt te mesiperm ju dergojme:

- Kontraten e nenshkruar me B.O "Modeste sh.p.k. & G.P.G. Company sh.p.k" (perfaqesuar me prokure "Modeste sh.p.k.") per objektin e mesiperm te prokurimit.
- Formulari i Ofertes fituese.
- Preventivin fitues te procedures se prokurimit.
- Kontraten e bashkepunimit lidhur ndermjet operatoreve ekonomike ne cilesine e anetareve te ketij bashkimi te perkohshem me qellim realizimin e objektit te prokurimit.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin, jemi te gatshem t'ju veme ne dispozicionin cdo dokument tjeter te nevojshem per monitorimin dhe realizimin e ketyre punimeve dhe sherbimeve te kesaj procedure prokurimi sipas kerkeses tuaj.

Drejtoria (Njesia) e Prokurimit Publik
Nevila ÇALA



Dr. P. Pashkaj!
ky objekt do te mbyllet
Er. Shupi
14/12/16



BASHKIA FIER

Adresa : Lagja "Kastriot", Rruga "Brigada e XI Sulmuese"; Tel/Fax : 034 410 636; www.bashkiafier.gov.al

Nr. 5822/6 Prot.

Datë 30/11/2016

KONTRATE SIPERMARRJE- Nr.43/231/2016 ME OBJEKT :

"RIPERTERITJE URBANE E BULEVARDIT RAMIZ ARANITASI"

Drejtuar : Dr. Shërbimeve Publike

PALËT :

- ❖ AUTORITETI KONTRAKTOR : BASHKIA FIER
- ❖ KONTRAKTOR : B.O "MODESTE SH.P.K.- & G.P.G.COMPANY SH.P.K.",

KONTRATE SIPERMARRJE Nr. 43/231/2016

“Riperteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi”



Lidhur sot, më 30/11/2016 midis Bashkise Fier, perfaqesuar nga Kryetari i Bashkise z.Armando SUBASHI nga njera ane dhe bashkimit te perkohshem te shoqerive "Modeste sh.p.k. & G.P.G. Company sh.p.k", me perfaqesues nga tjeter ane te tyre z.Refit Hyseni dhe z.Paqesor Buzi nga ana tjeter, te quajtur perkatesisht ketu e me poshte, Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Kontraktori.

PERKUFIZIME:

1. “Kontrate” do te thote Kontrate Siper marrje nr. 43/231/2016, me permbajtje dhe termat ne tekstin si me poshte. “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkengjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
2. “Vlefte e Kontrates” eshte vlefte e plote ne leke perfshi TVSH e fituar ne tenderin e dates 11.10.2016 te organizuar ne Bashkine Fier per ndertimin e ketij Objekti.
3. “Objekt” do te thote “Riperteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi” Fier, sipas Projektit te miratuar dhe Preventivit e Specifikimeve teknike te dhena e te pranuar ne tender.
4. “Autoriteti Kontraktor” eshte BASHKIA FIER.
5. “Kontraktor” eshte bashkimi i perkohshem te shoqerive "Modeste sh.p.k. & G.P.G. Company sh.p.k", me numer NIPT J62903413B & J64324443V.
6. “Preventiv” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje. Volumet dhe cmimet per secilin ze jane pjese e Ofertes Fituese dhe pjese e kesaj kontrate.
7. “Situacion Pjesor” do te thote situacioni per nje pjese te punimeve te preventivit, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituara ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH.
8. “Situacion Perfundimtar” do te thote situacioni per punimet e plota te percaktuara ne preventiv, ku percaktohen zerat, volumet me matje, cmimet e fituar ne tender, vlefte e tyre, TVSH-ja dhe Vlefte me TVSH, brenda vleres se fituar ne tender.
9. “Data e kryerjes se plote” do te thote data qe ndertimet duhet te mbarohen sic eshte shprehur ne grafikun per kryerjen e Ndertimeve.
10. “Kryerja” do te thote data e vertetuar se Ndertimet jane mbaruar.
11. “Difekt” do te thote cdo pjese e ndertimeve e parealizuar ne perputhje me specifikimet teknike te kontrates.
12. “Data e hyrjes” do te thote data qe Autoriteti Kontraktor lejon Kontraktorin ne Objekt dhe marrjen prej tij ne dorezim te Sheshit te Ndertimit me proces-verbal.
13. “Materiale” do te quhen te gjitha furnizimet duke perfshire edhe ato te konsumueshme, cilesia e te cilave vertetohet me certifikate, te perdorura nga Kontraktori per trupezimin e tyre ne ndertimin e objektit.
14. “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit
15. “Mbikqyresi i punimeve” (Supervizori) do te thote subjekt fizik/juridik i licensuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate Mbikqyrje per ndertimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar, U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit” dhe paraqiten ne Kontraten e Mbikqyrjes.
16. “Kolaudatori” do te thote subjekt fizik/juridik i licensuar me te cilin AK ka lidhur Kontrate per Kolaudimin e Objektit. Detyrat dhe pergjegjesite e tij jane percaktuar ne U.K.M. nr. 3 date 15.02.2001 “Per Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” te ndryshuar dhe paraqiten ne Kontraten e Kolaudimit.
17. “Ndertime” do te thote Projekt i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit, pjese perberese e Kontrates.
18. “Llogaritja e afateve” Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.
19. “Afati i Garancise se Punimeve” do te thote periudha prej 24 muaj e cila fillon nga data e shpalljes se kolaudimit te punimeve, gjate te ciles Kontraktori riparon me shpenzimet e tij cdo difekt qe ka ardhur si pasojë e shpalljes se punimeve te kryer prej tij.





10. "Garancia e Punimeve", eshte vlera prej 5% e vlefes se situacionit perfundimtar te miratuar.
11. "Baza Ilgjore" Kontrata do t'i nenshtrohet, do te qeveriset dhe do te interpretohet sipas ligjeve dhe dispozitave nenligjore ne fuqi te Republikes se Shqiperise, perfshire te gjitha dokumentat e tenderit dhe te ofertes se Kontraktorit te cilat jane pjese e kesaj kontrate sipas permbajtjes se tyre.
12. "Force Madhore" do te thote nje ngjarje qe nuk mund te kontrollohet nga palet, ku perfshihen, por nuk jane te limitizuara, lufta, revolucionet, zjarri permbytja, termeti, epidemite, karantina, embargo tranziti, etj.

I. OBJEKTI I KONTRATES

"Riprteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi", sipas Projektit, Preventivit te miratuar me zera e volume dhe specifikimeve teknike te pranuar ne tender te cilat jane pjese perberese e kesaj kontrate dhe perbejne detyrim ligjor per zbatim nga palet ne kete kontrate.

II. VLEFTA DHE AFATI I KONTRATES

Vlefte e fituar ne tender per perfundimin e punimeve ne total eshte **203 971 733.8 lekë me TVSH** (dyqind e tre milion e nentqind e shtatedhjete e nje mije e shtateqind e tridhjetete e tre pike tete), dhe afati i kryerjes se punimeve eshte 7 (shtate) muaj.

Ne baze te shkrese se ardhur nga Drejtoria e Pergjithshme e Buxhetit, prane Ministrise se Financave, me nr.8626/1 prot, date 06.07.2016, sipas vendimit te Komitetit te Zhvillimit te Rajoneve nr.31, date 13.06.2016 "Per shperndarjen e financimit per projektet e grantit "Infrastruktura vendore dhe rajonale ", programi: " Zhvillimi i Infrastruktures Vendore dhe Rajonale, shtylla e I, thirrja e II per vitin 2016", e ardhur ne Bashki me shkresen me nr.4572 prot., dt.08.07.2016, kontraktohet me vlere te plote, por per vitin 2016 do te financohet ne vleren 103 478 228 (njqind e tre milion e katerqind e shtatedhjete e tetemije e dyqind e njezete e tete) leke me TVSH, pjesa tjeter do te financohet ne vitet ne vijim, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.



Kontraktori eshte i detyruar te perfundoje te gjitha punimet (volumet e parashikuara ne preventiv) sipas afateve te zbatimit te punimeve dhe konform specifikimeve teknike dhe standarteve perkatese pavaresisht financimit.

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

Ne vleften totale te mesiperme perfshihet TVSH, si dhe te gjitha detyrimet e tjera fiskale ne Republiken e Shqiperise.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E AK

1. Te njohje zyrtarisht Kontraktorin me Mbikqyresin, Kolaudatorin, si dhe t'i dorezoje atij nga nje kopje te Kontrates se Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit. Nga ana e Bashkise Fier do te vendoset nepermjet procedures se prokurimit, si perfaqesues prane sipermarresit, mbikeqyresin e punimeve.
2. Te marre te gjitha masat pergatitore per lirimin e Sheshit te Ndertimit dhe te lejoje Kontraktorin te hyje ne Objekt dhe ta dorezoje ate me proces-verbal ne prani te Mbikqyresit.
3. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës dhe Kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. *Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.* (Neni 18 i KPK tek DST)
4. Brenda dates se hyrjes te siguroje te gjitha lejet e nevojshme ligjore ne menyre qe t'i krijoje kushte pune normale Kontraktorit.
5. Te miratoje situacionin pjesor dhe situacionin perfundimtar te paraqitur e te miratuar nga Mbikqyresi.
6. Te asistojte ne procesin e kolaudimit perfundimtar te Objektit.
7. Ka te drejte qe per te realizuar me se miri anen funksionale te Objektit, te beje ndryshime jo thelbesore ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit. Ndertimet shtese mund te porositen vetem ne rrethana te percaktuar ne LPP dhe U.K.M. Nr.2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit" dhe me kusht qe shtesa e kontrates te mos i kaloje 20% te cmimit original te kontrates.
8. Autoriteti Kontraktor ne cdo kohe, mund te porosise kontraktorin te beje ndryshime brenda qellimit te pergjithshem te kontrates ne secilin nga elementet e meposhtem (neni 36.3 i KPK tek DST):
 - a) Korrigjime ne projektin, zbatimin ose specifikimet e Punëve





11. Kontrollimi në material

Paspara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materializojë amendamentet e marreveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marreveshjes.

10. Te marre ne dorezim Objektivin pas kolaudimit perfundimtar.
11. Te vëri ne shfrytezim Objektivin dhe pas perfundimit te Afatit te Garancise te leshoje certifikaten e garancise se punimeve.
12. Te verifikojë kryerjen e riparimit te difekteve te ndodhura dhe per ato qe nuk jane eliminuar llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlefte e garancise se punimeve.
13. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) kontraktori dështon në kryerjen e punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë;
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim të detyrimeve dhe kushteve të kontratës për një afat 15 ditë ti plotësojë ato, me përjashtim të rasteve kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

III. TE DREJTAT DHE DETYRAT E KONTRAKTORIT (SIPERMARRESIT)

1. Te siguroje Kontraten ne vleren 10% te vlefte totale te kontrates para lidhjes se saj. Sigurimi i Kontrates te behet ne formen e Garancise Bankare ose Siguracion ne nje nga shoqerite e sigurimeve te licensuara.
2. Kontraktori eshte i detyruar te siguroje prane shoqerive te sigurimit, nga Data e hyrjes ne objekt deri ne Afatin e Mbarimit te punimeve, te gjitha elementet e percaktuar ne piken 6.1 te Shtojces 18(KVK) te DST, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
3. Te marre ne dorezim Objektivin duke reflektuar ne proces-verbalin perkates gjendjen teknike te tij.
4. **Data e fillimit te punimeve eshte data e marrjes se Objektivit (sheshit te ndertimit dhe lejes se ndertimit) ne dorezim dhe emerimit te mbikqyresit te punimeve nga AK.**
5. Menjehere pas lidhjes se kontrates, Kontraktori duhet t'i paraqese mbikqyresit te punimeve nje program plani qe tregon metodat e pergjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve.
6. Te caktojë drejtuesin/it teknik te tij ne perputhje me licencen e paraqitur ne tender, te cilet do te drejtojne te gjitha punimet per zbatimin e Projektit te Zbatimit dhe te njoftoj zyrtarisht Mbikqyresin e punimeve dhe AK, duke paraqitur edhe dokumentacionet ligjore te tij/tyre.
7. Te njohe, te respektojë termat e Kontrates te Mbikqyrjes dhe Kontrates se Kolaudimit dhe t'i krijojë kushte normale pune Mbikqyresit dhe Kolaudatorit.
8. Te realizojë Projektin e Zbatimit ne perputhje me Specifikimet Teknike dhe t'i perfundojë punimet ne perputhje me volumet e punes per cdo ze te preventivuar per jo me shume se 7 muaj.
9. Te pranojë cdo ndryshim jo thelbesor te miratuar nga Investitori ne Projektin e Zbatimit dhe ne Preventivin e Zbatimit brenda vleres se Kontrates.
10. Gjate kryerjes se punimeve, te njoftojë ne kohe dhe zyrtarisht Investitorin per ato raste te mosperputhjes se Projektit te Zbatimit dhe te Preventivit te Zbatimit. Deri ne paraqitjen zyrtare te qendrimit te Investitorit per ceshtjet e ngritura, Sipermarresi duhet te nderprese (pezullojë) punimet.
11. Periudha e nderprerjes se punimeve duhet te pasqyrohet ne Proces-Verbalin perkates dhe te vertetohet nga Mbikqyresi i punimeve. Periudha e nderprerjes te punimeve per arsyt e shprehura ne piken 9 te kapitullit IV, merret ne konsiderate per llogaritjen e afatit te perfundimit te punimeve, duke shtyre afatin e dorezimit te punimeve per aq kohe sa zgjat nderprerja e punimeve.
12. Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe planin e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshtuar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.





...transportin, makinerite, fuqine puntore, drejtimin teknik dhe bazen materiale te nevojshme ne perputhje me specifikimet teknike dhe dokumentat e paraqitur ne tender dhe te paraqese certifikatat e cilesise se tyre. Nuk i lejohej qe rolli e sipermarrjes t'ia jape nje subjekti tjetër.

14. Te paraqese tek AK per miratim dhe per te realizur likuidimin e punimeve, Situacion/e te pjeseshm/e per punimet e kryera dhe Situacion Perfundimtar. Situacionet te jene te miratuara edhe nga Mbikqyresi i Punimeve.
15. Te njoftoje me shkrim AK per daten e perfundimit te punimeve dhe kerkesen per kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te Objektit. Ky njoftim duhet te behet jo me vonë se **5 (pese)** dite para dates se perfundimit te punimeve.
16. Defektet e konstatuara gjate procesit te kolaudimit dokumentohen dhe nga kolaudatori lihen detyra dhe afate me shkrim per ndreqjen e tyre, keto kosto do te perballohen nga Kontraktori.
17. Kontraktori mban pergjegjesi dhe perballon rreziqet per demtimin dhe humbjen e materialeve dhe prones publike e private te te tretteve, plagosjen, demtimin apo vdekjen e punonjesve te tij apo personave te trete nga mosrespektimi i rregullave te sigurimit teknik etj. Kontraktori mban pergjegjesi per zbatimin e akteve ligjore e nenligjore ne fushen e ndertimeve.
18. T'i paraqese Mbikqyresit te Punimeve dhe Kolaudatorit te gjithë dokumentacionin shkresor te perditesuar dhe perfundimtar, si dhe certifikatat e provave te perdorura ne Objekt, te cilet mbas verifikimit dhe pranimit i administrojne ne dosjen e Objektit.

IV. TE TJERA

1. Menyra e komunikimit midis paleve do te jete vetem me shkrim. Bashkia Fier ne baze te Kontrates se bashkepunimit dhe Prokures se Posacme te Bashkimit te Perkohshem te ketyre shoqerive njeh dhe mban kontakte me perfaqesuesin e autorizuar te ketij bashkimi, shoqerine "**Modeste**" shpk Fier.
2. Secila anetare e ketij bashkimi te perkohshem shoqerish merr persiper te gjitha pergjegjësitet dhe detyrimet perpara Bashkise Fier si veç e veç ashtu edhe bashkerisht (detyrim solidar), si persa i perket cilesise se punimeve, afatit te kryerjes se tyre dhe çdo pergjegjësije tjetër te ligjshme qe do te rrjedhe nga kjo kontrate Sipermarrje, bazuar ne nenin 431 te Kodit Civil te R.SH.
3. Per çdo çeshtje qe lind gjate zhvillimit te punimeve, midis paleve kryhen negociata per zgjidhjen e tyre.
4. Ne qofte se Kontraktori braktis Objektivin pa e perfunduar ate, duke zgjidhur Kontraten ne menyre te njeanshme, Ai detyrohet te paguaj demin qe i shkakton Bashkise Fier dhe Garancine e Kontrates.
5. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfunduara do të bëhen pronë e Autoritetit Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj.
6. Palet nuk çlirohen nga çdo pergjegjesi per mos zbatimin e termave te kesaj e Kontrate, pervec se ne rast te veprimit te forcave madhore te vertetuara nga Institucionet Zyrtare.
7. Kontraktori, Mbikqyresi i punimeve dhe Kolaudatori jane te detyruar te kontaktojne zyrtarisht me Specialistin e Investimeve prane Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve Publike te Bashkise Fier, pasi ky i fundit do te jete personi i kontaktit i cili do te monitoroje gjithë procesin e zbatimit te punimeve, per kete objekt kontrate.
8. Per çdo dite vonese tej afatit te punimeve, Kontraktori eshte i detyruar t'i paguaj Investitorit, **gjobe ne masen 4/1000** të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
9. Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bere llogaritja e tyre.
10. Veprimet financiare per llogari te kesaj Kontrate do te kryhen me shoqerine "**Modeste**" shpk Fier, qe perfaqeson bashkimin e perkohshem ne Raiffeisen Bank (dega Fier) nr. e llogarise Nr. **ALL0300001418** dhe IBAN **AL84 2022 10050000000300001418**.
11. Çdo mosmarreveshje qe do te linde gjate zbatimit te kesaj Kontrate, palet do ti zgjidhin me mirekuptim, ne te kundert do t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Fier.
12. Pjese perberese e kesaj Kontrate jane edhe Projekti i Zbatimit dhe Preventivi i Zbatimit me cmime qe eshte paraqitur ne tender nga Sipermarrresi si dhe Specifikimet Teknike te punimeve te pranuar dhe Grafiku i Punimeve.
13. Çertifikata e Garancise se Punimeve leshohet pas perfunimit te Afatit te Garancise qe **para 24 maj**, pasi Kontraktori, Mbikqyresi, Kolaudatori dhe AK kane inspektuar Objektivin dhe kane konstatuar qe nuk ka defekte dhe punime te pakryera si dhe qe ai funksionon ne perputhje me Projektin.



14. Per difektet qe nuk jane ndrequr gjate Afatit te Garancise se punimeve te ndertimit, AK llogarit koston e ndreqjes se tyre dhe bene ndalesen nga vlera e Garancise se punimeve qe eshte ne masen 5% te vleres totale te Kontrates.
15. Çmimet e punimeve do te jene ato te fituara ne tender, sipas preventivit te paraqitur nga Sipermarresi.
16. Bashkia Fier mund te beje ne çdo kohe porosi tek Kontraktori per te bere ndryshime (specifikime teknike) brenda qellimit te pergjithshem te kontrates.
17. Kontraktori eshte i detyruar qe te njoftoje dhe te rakordoje perpara, ne vazhdim dhe ne perfundim te punimeve me KESH, ALBTELEKOM, UJESJELLES-KANALIZIM sh.a per zgjidhjen bashkarisht te problemeve te infrastruktures se tyre, qe te jene prezente me specialistet e tyre kur do te kryhen punime te cilat kane te bejne me proceset teknike-specifike apo me levizjet e materialeve ose objekteve te cilat jane ekskluzivitet i subjekteve te mesiperme. Afati i njoftimit per keto subjekte do te jete 5 (pese) dite perpara kryerjes se punimeve.
18. Kjo Kontrate hartohet ne 6 kopje, 1 per Kontraktorin dhe 5 per Bashkine Fier dhe pasi lexohet nga palet, nenshkruhet prej tyre me vullnet te lire ne Fier sot me date 30/11/2016.

Adresa :

Bashkia Fier, L. "Kastriot", Rr. "Brigada e XI Sulmuese"
www.bashkiafier.gov.al Fier

Adresa :

B. O. : "Modeste sh.p.k. & G.P.G. Company sh.p.k"
 Lagja "1 Maji"; Fier.


Për dhe në emër të :

Për dhe në emër të :

AUTORITETIT KONTRAKTOR

BASHKIA FIER

Armando SUBASHI
 KRYETAR I BASHKISE




KONTRAKTORI

BO. "Modeste" shpk Fier & "G.P.G. COMPANY sh.p.k." Lushnje

z.Refit HYSENI
 PËRFAQËSUESI LIGJOR



z.Paqes BUZI
 PËRFAQËSUESI LIGJOR



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
NOTER KADRI Bilali
Nr. 2074 Rep. Nr. 1774 Kol.



KONTRATE
(PER BASHKIMIN E PERKOHSEM TE SHOQERIVE)

Ne Ballsh sot me date 08.10.2016 para meje Noterit Kadri BILALI me seli ne Ballsh u paraqiten personalisht palet kontraktuese :

- Shoqeria "Modeste" shpk me seli ne Fier rregjistruar si person juridik pajisur nga organet tatimore me Nipt J62903413B perfaqesuar nga z.Xhentil Kotobelli , i datelindjes 28/04/1960 lindur ne Frishte Skrapar e banues ne Tirane , madhore, me zotesi te plote per te vepruar , njohur prej meje noterit me pasaporte BJ9186880 dhe numer personal G00428048U
- Shoqeria "G.P.G Company " Shp.k. me Nr. NIPTI- i J64324443V me seli ne Lushnje , perfaqesuar nga administratori i saj z.Paqsor Buzi , lindur me 03/09/1970, ne Lushnje dhe banues ne Lushnje, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga karta e identitetit nr.025077529 dhe numer personal H00903078F
- .Keto shoqeri referohen si pale te kesaj kontrate.

OBJEKTI I KONTRATES : Bashkim i Perkoheshem i paleve per zbatimin e objektit:
AUTORITETI KONTRAKTOR : Bashkia FIER
OBJEKTI : " "Riperteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi "

BAZA LIGJORE E KONTRATES

Kontrata e bashkepunimit do te rregullohet sipas normave te parashikuara ne kete kontrate dhe dispozitave ligjore te sanksionuara ne Kodin Civil ,Pjesa V e tij, Kontrata -Kontrata ne Pergjithesi ,Kreu I Dispozita paraprake nenet 659,660.661.676.677.681-690 , Ligjit Nr 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurorimin Publik", te ndryshuar,ligjit nr 7829 dt 01/06/1994 Per Noterine (i ndryshuar) si dhe vendimit nr 1 date 10/01/2007 I K.M (i ndryshuar) , " Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Kreu 7 :Kushte te Pergjithshme per zbatim ,pika 2/a,b ,c

Duke qene se Bashkia Fier do te jape ne sipermarrje kete objekt, si dhe duke qene se palet pjesemarrrese ne kete kontrate deshirojne te marrin ne sipermarrje kryerjen e punimeve, eshte rene dakort si me poshte:

NENI 1: (Qellimi)

Per paraqitjen e nje oferte konkuruese ne tender dhe ne rast suktesi per kryerjen e punimeve tendertimit te Objektit: "Riperteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi "



Shoqeria "Modeste" Sh.p.k., Shoqeria "G.P.G Company" Shpk bien dakort qe te bashkojne forcat dhe kompetencat e tyre ne kuadrin e nje bashkepunimi te perkoheshem ne nje grup te vetem (referuar me poshte si "grupi").

Ky bashkepunim eshte eskuziv dhe reciprok dhe secila pale merr persiper konfidencialitetin e ketij bashkepunimi si dhe mos bashkimin me asnje pale tjetere te trete.

NENI 2: (Perfaqesimi dhe Pergjegjesite)

Shoqeria "Modeste" Sh.p.k do te veproje si udheheqese dhe perfaqesuese e grupit kundrejt Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier, duke kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per llogari te Bashkimit te Shoqerive(Grupit):

Perfaqesuesi do te perfaqesoje Shoqerite ne lidhje me proceduren e konkurimit shpallur nga Bashkia Fier me objekt "Riperteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi"

Perfaqesuesi do perfaqesoje bashkimin e operatoreve si ne dorezimin e kualifikimeve dhe te ofertes, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi, ashtu dhe ne lidhjen e kontrates ne rast te shpalljes fitues. Perfaqesuesi duhet te beje dhe sigurimin e ofertes, duke specifikuar pjesemarrjen si bashkim te operatoreve ekonomike.

Perfaqesuesi ka te drejte gjithashtu te nenshkruaje dhe te depozitoje te gjitha aktet e nevojshme si dhe te ndjeke procedurat perkatese prane te gjitha autoriteteve publike, apo perpara personave te trete fizike apo juridike, te nevojshme per realizimin e objektit te prokurimit te siperpermendur, si ne fazen para dhe gjate zhvillimit te gares, ashtu edhe ne ate pas saj.

Per kryerjen e veprimeve te caktuara, Perfaqesuesi do te kete te drejten te autorizojte persona te trete.

Shoqeria "Modeste" Sh.p.k., Shoqeria "G.P.G Company" Shpk bashkojne kapitalet, bilancet e tyre, makinerite, paisjet, fuqine punetore, stafin teknik, e te tjera dhe jane pergjegjese solidarare per punimet e kryera, detyrimet kontraktuale dhe ne menyre te vecante per zbatimin e kushteve te kontrates dhe te grafikut te punimeve.

Pavaresisht nga perqindjet e pjesemarrjes se shoqerive si me siper ne kete bashkim te perkohshem te treja shoqerite pjesemarrrese ne kete bashkim te perkohshem do te jene pergjegjese individualisht dhe ne menyre solidarare ndaj Autoritetit Kontraktues ne lidhje me Kushtet e Percaktuara ne Kontraten e Prokurimit, konform nenit 423 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

NENI 3: (Pjesemarrja)

Pjesemarrja ne zbatimin e kontrates, do te jete e perbashket, e shprehur ne perqindjet e meposhtme:

Shoqeria "MODESTE" Sh.p.k.	19 % (nentembedhjete) Perqind
Shoqeria "G.P.G Company" Sh.p.k	81 % (tetedhjete e nje) Perqind

Shoqerite ne bashkepunim me njera tjetren, marrin persiper kryerjen e puneve perkatese te parashikuara ne preventivin e punimeve dhe konkretisht:

Shoqeria "Modeste" Sh.p.k merr persiper kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit ne perputhje me perqindjen e shenuar me siper,

Shoqeria „G.P.G Company „Shpk merr persiper kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit ne perputhje me perqindjen e shenuar me siper,
Realizimi i punimeve te parashikuara ne preventiv jane te ndare vecmas per secilin operator te ketij bashkimi dhe i bashkangjiten kesaj kontrate .



NENI 4: (Ndarja e Fitimit)

Ndarja e fitimit do te jete ndermjet paleve eshte e percaktuar konforme perqindjeve;
Shoqeria "MODESTE" Sh.p.k. 19% (nentembdhjete) Perqind
Shoqeria "G.P.G Company" Sh.p.k 81% (tetedhjete e nje) Perqind

NENI 5: (Organizimi i kryerjes se punimeve)

Palet bien dakort qe te themelojne ne rolin e kordinatorit te ketij grupi nje staf independent, detyrat e pergjegjesite e te cilit do te percaktohen ne nje kontrate te detajuar ne rastin e shpalljes fitues te ketij grupi.

NENI 6: (Shpenzimet)

Do te kryhen nga Shoqeria " MODESTE " Sh.p.k., shoqeria "G.P.Company "shpk , dhe shpenzimet per pregatitjen e ofertes do te perballohen nga te treja palet ne perqindje sipas perqindjes se pjesmarrjes ne grupim.

Shpenzimet per garancine e kontrates, si dhe te gjitha garancive te tjera te kerkuara do te perballohen ne menyre te perbashket sipas perqindjeve te percaktuara ne pjesmarrjen e ketij grupi per çdo pale.

Palet do te jene pergjegjese dhe do te perballojne shpenzimet qe rrjedhin nga detyrimet kontraktuale bashkerisht.

NENI 7:(Zgjidhja e mosmarreshjeve)

Kontrata mes paleve do te zgjidhen me mirekuptim. Ne te kundert kompetente per zgjidhje do te jete Gjykata e Rrethit Tirane.

Kontrata pasi u hartua dhe u lexua nga palet dhe si u gjet ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe te plote u nenshkrua prej tyre pa verejte ne pranine e noteress. Une noterja e vertetohet ate konform ligjit.

PALET KONTRAKTUALE

SHOQERIA "MODESTE " Sh.p.k

SHOQERIA "G.P.G Company " Sh.p.k.

Administrator



Administrator



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra e Noterise - Mallkaster
VERTETOHET

NOTER
KADRI BILALI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE VLORE
NOTER PUBLIKE
Nr. 2075 Rep. Nr. 775 Kol.



PROKURE E POSACME

Ne Ballsh sot me date 08.10.2016 para meje Noterit Kadri Bilali me seli ne Ballsh u paraqit personalisht shtetasi i poshteshenuar :

Shoqeria "G.P.G Company " Shp.k. me Nr. NIPTI- i J64324443V me seli ne Lushnje , perfaqesuar nga administratori i saj z.Paqsor Buzi , lindur me 03/09/1970, ne Lushnje dhe banues ne Lushnje, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar nga karta e identitetit nr.025077529 dhe numer personal H00903078F

Keto shoqeri referohen si pale te kesaj kontrate.

BAZA LIGJORE:Neni 70-72 i K, civil, neni 96 e ne vijim te K.Pr.Civile dhe nenit 39 te ligjit 7829 date 01.06.1994:Per noterine :Ndryshuar me ligjin numer 9216 date 01.04.2004.

I perfaqesuari shoqeria ""G.P.G Company " Shp.k . deklaroi si me poshte vijon:

Emeroje dhe caktojme si Perfaqesuesin tone te posacem "Modeste " Sh.p.k per te na perfaqesuar ne tenderin qe zhvillon Autoriteti kontraktor, Bashkia Fier , me objekt;
""Riparteritje urbane e bulevardit Ramiz Aranitasi "

Ne lidhje me perfaqesimin me kete tender une I perfaqesuari ne cilesine e administratorit te shoqerise "G.P.G Company "Shpk ,caktoje si perfaqesuesin tim shoqerine "MODESTE " Sh.p.k qe ne emer dhe per llogarine e shoqerise se perbashket te krijuar qe prej nesh te kete te drejte te me perfaqesojte prane autoritetit kontraktor persa I perket kryerjes se procedures ligjore qe lidhet me pergatitjen , me pas futjen e dokumentacionit te tenderit te hapur te siperpershkruar, tender per tecilin sipas vendimit nr 1 date 10/01/2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit public"(I ndryshuar) Kreu 7 "Kushte te Pergjithshme per zbatim" kemi nenshkruar ligjerisht edhe nje kontrate bashkepunimi si dhe ne tere proceduren e permbushjes se detyrimeve kontrataktuale dhe realizimit te objektit te ketij tenderi ,ne rast te shpalljes fitues te bashkimit te operatoreve tane dhe lidhjes se kontrates me Autoritetin Kontraktor.

Persa me siper perfaqesuesi ka te drejte

1-Te ndjeke ecurine zhvillimit te tenderit sipas procedurave ligjore ne fuqi ,ligjit per Prokurimet publike dhe akteve nenligjore te dala ne dhe per zbatim te tij.

2-Te kundershtojte vendimet e Komisionit te tenderimit ne rruge administrative dhe gjyqesore nese do te jete e nevojshme duke patur te drejten ai te paraqese padi ose kunderpadi si dhe te ushtroje ligjerisht cdo te drejte tjeter ne pozitat qe ia njej ligji dhe KPr.C , ne mbrojtje te te drejtave dhe interesave te ligjshme qe burojne nga pjesemarrja ne kete tender duke ndjekur ceshtjen ne te



gjitha shkallet e gjykimit ne rast te shkeljes se procedurave te tenderimit (ne cdo rast duke vepruar vete apo dhe duke caktuar mbrojtjes ligjor sipas ligjit)

Me kete prokure Shoqeria "MODESTE " Sh.p.k caktohet si perfaqesuese e shoqerise se perbashket e cila do te na perfaqesoje ne tender dhe ne rast te shpalljes fitues edhe gjate zbatimit te kontrates .Kontrata (ne rast te shpalljes fitues te bashkimit te opretatoreve) do te nenshkruhet nga secili prej anetareve te ketij bashkimi.

Shoqeria "MODESTE " Sh.p.k ka te drejte te kryje cdo veprim tjeter juridik edhe pse I pashprehur ne kete prokure e te lejuar me ligj ne emer dhe per llogari te shoqerise "G.P.G COMPANY " Shpk vetem persa I takon realizimit dhe permbushjes se detyrimeve per sherbimin sipas kontrates se bashkepunimit te lidhur midis nesh nr rep nr kol date . Ai ne kete cilesi eshte I autorizuar te ushtroje cdo te drejte apo te realizoje cdo detyrim qe do te kerkoet ne perputhje me legjislacionin ne fushen e tenderimit , apo rregullat e percaktuara ne dokumentacionin e tenderit objekt te kontrates se bashkepunimit te lidhur midis nesh, te cilat do te kerkonin prezencen e nje perfaqesuesi te caktuar prej nesh per efekt te depozitimit apo te terheqjes se dokumentave, te fimosjes se ofertes apo realizimit te cdo traktative tjeter, te nenshkrimt te cfaredolloj dokumentacioni , situacioni, preventiv , fatura , kerkesa te ndryshme , formulare , te beje pagesa te ndryshme , si ne proceduren e tenderit ashtu edhe ne te gjitha proceduren e realizimit dhe permbushje sse detyrimeve te kontrates , ne rast te shpalljes fitues te bashkimit te opretatoreve tane , gjithmone ne funksion te realizimit te qellimit te krijimit te kesaj shoqerie te perbashket.

Ne permbushje te tagrave te kesaj prokure, Perfaqesuesi ne fjale eshte ne menyre te vecante i autorizuar dhe i pajisur me tagra e te drejta te marre te gjitha informacionin, njoftimet, ankesat e tjera; te jape deklarata ne emer te bashkepunimit, te nenshkruaje te gjitha aktet ligjore perkatese qe kane per objekt bashkepunimin e shoqerive per Tenderin e sipershenuar, te paraqese ankesa e te kerkoje dokumenta ne institucione apo gjykata te cdo niveli, te marre pjese ne ekzekutimin e vendimeve, e te ndermarre cdo veprim tjeter qe nuk eshte specifikuar ketu por qe do te konsiderohet i nevojshem per te siguruar zbatimin e kontrates se bashkepunimit te nenshkruar ndermjet paleve. Cdo veprim i kryer nga perfaqesuesi ne kuadrin e porosive te dhena do te konsiderohet i drejte e i mireqene nga ana jone. Per kryerjen e veprimeve te caktuara, Perfaqesuesi do te kete te drejten te autorizojte persona te trete.


Te gjitha veprimet e kryera nga perfaqesuesi brenda kopetencave te percaktuara me lart, do ti konsiderojme te drejta dhe te mireqena njelloj sikur te jene kryer nga ne personalisht.

Kjo prokure e posacme u perpilua me vullnetin e lire te vete perfaqesuarit, i cili deklaroi se eshte i vetedijshem per pasojat ligjore qe rrjedhin prej kesaj prokure, dhe ne kete akt eshte shprehur vullneti i tij i lire dhe i plote dhe firmosi rregullisht para meje noteres. Une noter e vertetoj ne baze te ligjit.

I PERFAQESUARI
"G.P.G Company " Sh.p.k
Administrator



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra e Noterise - Mallakaqar
VERTETOHET



NDARJA E PUNIMEVE SIPAS SHOQERIVE

OBJEKTI : RIPERTERITJA URBANE E BULEVARDIT "RAMIZ ARANITASI " FIER
(PUNIME NDERTIMORE RRUGORE)

Nr.	Analize	PUNIME NDERTIMORE RRUGORE				Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
		Emertimi i punimeve	PUNIME RRUGORE						
1	3.89/b	Germim dheu me esk. gom. 0.25m ³ ne kanale me gjer. >2m tok. zak kat.III shkar ne mjet(kasonet)	m3	2735	300	820,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
2	3.198	Cilindrim Kasonete me rul	m2	840	25	21,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
3	Ana.	Cmontim bordure betoni	ml	568	100	56,800.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
4	An-49(M-3)	Prishje struktura betoni	m3	25	3500	87,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
5	2.426/2	Prishje mur biloqe betoni	m3	2	800	1,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
6	3.197/1	Prishje shtrese cakulli t=15cm	m2	40	150	6,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
7	Ana.	Prishje trotuar me pllaka	m2	4170	250	1,042,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
8	An(M-3)	Skarifikim shtrese asfalti me makineri	m2	14730	200	2,946,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
9	An(M-3)	Sperkatje me emulsion bituminoz 1 l/m ²	m2	14730	180	2,651,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
10	Ana.	Prerje me sharre e asfaltit	ml	550	500	275,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
11	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	840	1000	840,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
12	3.210	Shtrese çakelli mbeturine kave t=15cm, perhapur e ngjeshur makineri	m2	865	900	778,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
13	3.212	Shtrese çakelli t=15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri	m2	770	650	500,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
14	3.212/b	Shtrese stabilizant t=10cm	m2	2805	450	1,262,250.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
15	3.212/1a	Shtrese konglomerati t=10cm	m2	24	1900	45,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
16	3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm.me makineri	m2	660	1700	1,122,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
17	3.226/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	15390	1400	21,546,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
18	3.226/1a	Shtrese asfaltbetoni me ngjyre me granil guri kave, 4cm, me makineri	m2	101	1600	161,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
19	3.224/1a	Shtrese me asfaltbetoni me gjyre me granil gur kave 3cm me makineri	m2	1839	1400	2,574,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
20	3.239	Strukt monolite beton C7/10 ... (M-100) nen.bordure	m3	46	9000	414,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
21	3.240	Buto beton me gure lumi 25% C7/10	m3	14	7000	98,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
22	3.241	F V bordura betoni 20x35 cm	ml	770	1500	1,155,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
23	3.619/a	F V bordura betoni 6x20 cm	ml	1430	500	715,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		
24	3.183/b	Shtres Zhavorr Lumi t=15 cm	m2	2460	300	738,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk		

25	3.183/a	Shtres Zhavorri Lumi t=10 cm	m2	375	230	86,250.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
26	3.184/a	Shtres Zhavorri Lumi t=30 cm	m2	167	500	83,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
27	Ana.	Shtres betoni me rere Kuarci	m2	910	1100	1,001,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
28	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (Kuneta)	m3	45	11000	495,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
29	3.158/5a	Transport dheu me makineri 5 km	m3	2790	270	753,300.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
		PUNIME TROTUARI		SHUMA 1		42,278,400.0	
1	3.25/a	Germim dheu me krah	m3	70	700	49,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
2	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	658	300	197,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
3	3.616	Betonim bordure 10 x 30 cm M-200 monolite	ml	1395	600	837,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
4	2.288	Trotuar me pllaka betoni, t=6cm	m2	7360	2000	14,720,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
5	2.288/a	Trotuar me pllaka betoni, t=6cm(pllaka gjendje)	m2	2090	1200	2,508,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
6	2.520	Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm	ml	3182	1200	3,818,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
7	2.521	Tub kanalizimi pvc Ø 140 mm	ml	3182	1400	4,454,800.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
8	An-19(M-2)	Indertim puseta betoni 0.8x0.8x1 per rrjetin nentokesor	cope	48	33500	1,608,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
9	3.379	Mbushje me rere (per rrjetin nentokesor)	m3	578	1800	1,040,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
10	An-56	F.v Tuba metalij Ø140 mm (ne kalimet e rruges)	ml	230	1700	391,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
11	An-57	F.v Tuba metalij Ø 219 mm (ne kalimet e rruges)	ml	230	2000	460,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
12	3.158/5a	Transport dheu me makineri 5 km	m3	728	270	196,560.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
		PUNIME GJELBERIMI DHE SINJALISTIKE		SHUMA 2		30,280,560.0	

1	3.25/a	Germim dheu me krah	m3	12	700	8,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
2	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	98	300	29,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
3	3.4	Prerje e sistemim pemesh ø 21 - 40 cm	cope	115	150	17,250.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
4	3.643	Mbjellje bari	m2	2245	90	202,050.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
5	2.19	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria III	m3	453	200	90,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
6	Ana	F.V Kosha mbeturinash te zhytur ne toke	cope	16	350000	5,600,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
7	3.183/a	Shtrese zhavorri, t=10	m2	90	230	20,700.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
8	3.246	Struktura monolite betoni C-20/25	m3	35	12000	420,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
9	3.378	Mbushje me zhavorr	m3	55	1100	60,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
10	2.421	Pergatitje e vendosje lende e sharruar	m3	1.6	36000	57,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
11	Ana	F.v Stol hekur I derdhur + dru	cope	27	13000	351,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
12	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (Stola+bordura lulishte)	m3	116	11000	1,276,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
13	An164(M-3)	F.V. Fidane Peme dekorative	cope	226	9000	2,034,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
14	An165(M-3)	F.V. Fidane shkurre dekorative "Oleander"	cope	145	1500	217,500.0	shoqeria "Modeste".shpk
15	An163(M-3)	F.V. Fidane lule dekorative	cope	1380	180	248,400.0	shoqeria "Modeste".shpk
16	Ana	F.V Kosha metalik te vegjel	cope	60	7000	420,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
17	3.619/a	Bordura betoni 6x20 cm per lulishte	ml	603	500	301,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
18	3.287	F.V Hekuri betoni I zakonshem < ø 6 - 10	Ton	2.16	100000	216,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk



19	An152	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	4150	350	1,452,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
20	An151	Vizime me boje bikomponente	m2	660	1400	924,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
21	An96(M-3)	F.v Tabela tetekendore e vogel me A-B, 60-20 (e kompletuar)	cope	22	8500	187,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
22	An158(M-3)	FV tabela te ndryshme rugore D=60cm	cope	15	5000	75,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
23	3.158/5a	Transport dheu me makineri 5 km	m3	110	270	29,700.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
			SHUMA 3			14,239,100.0	
			SHUMA 1+2+3			86,798,060.0	

PUNIME PER RIKONSTRUKSIONIN E FASADAVE

A. Punime prishjeje + transport

1	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	155	600	93,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
2	2.426/6	Prishje struktura betoni/arme	m3	90	3500	315,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
3	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	135	3500	472,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
4	An	Heqje dyer, dritare, vetrata	m2	940	200	188,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
5	An	Heqje veshje fasade alukobond	m2	46	300	13,800.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
6	An	Prishje suvatimi fasade e jashtme	m2	2890	200	578,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
7	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5km	m3	412	270	111,240.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
			SHUMA 4			1,771,540.0	

B. Punime per rehabilitimin e fasadave

1	2.64/1	Mur me tulle plota ne lartesi deri 3m me llaç perzier M 15	m3	65	17000	1,105,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
2	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h=8 m	m2	4550	870	3,958,500.0	2734m2 shoqeria "Modeste".shpk shoqeria "G.P.G. Company".shpk
3	2.334	Suva e zakonshme fasade mur tulle h>8 m	m2	21557	1050	22,634,850.0	13500m2 shoqeria "Modeste".shpk shoqeria "G.P.G. Company".shpk
4	2.355	Veshje fasade me plaka qeramike importi	m2	2530	3500	8,855,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
5	2.268/a	Shkalle montazhi mermeri (parmak i dritareve, l=2cm)	m2	60	4500	270,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
6	2.407	Pllake b/a granili mbi parapet tarace	m2	125	4000	500,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
7	An	Veshje muri me 1 shtrese pllake gipsi	m2	20	1400	28,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
8	2.414	F.V zgara dekorative hekuri me figuracion dekorativ (Kangjellat)	ton	0.15	137000	20,550.0	shoqeria "Modeste".shpk
9	2.410/a	Parapet ballkoni me tuba inoxi ngjyre e verdhe ose metalizato, h=80~90cm	ml	22	6500	143,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
10	2.410/b	Parapet ballkoni me tuba inoxi ngjyre e verdhe ose metalizato, h=30~50cm	ml	70	3500	245,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
11	2.401	Boje vaji sipërfaqe metalike(per kangjellat ekzistuese)	m2	70	400	28,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
12	2.404/a	Boje hidroplastike importi cilesi e l-re	m2	37790	430	16,249,700.0	22750m2 shoqeria "Modeste".shpk shoqeria "G.P.G. Company".shpk
13	2.358/b	Veshje fasade me polisterol kompakti jeshil l=5cm + rrjete + suva.	m2	215	2800	602,000.0	shoqeria "Modeste".shpk
14	2.358/c	F.V kolone gipsi me permasa 13x30cm	ml	98	1200	117,600.0	shoqeria "Modeste".shpk
15	2.308/a	Suvatimi me grafiato h > 4 m	m2	135	1000	135,000.0	shoqeria "Modeste".shpk



Handwritten signature

26	3. An/1/1	F.V tuba te brinjzuar HDPE SN8 d=315 mm	ml	54	3500	189,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
27	2.262/4	Shtrese betoni C16/20 per fiksim tubi pvc -200mm	m3	63	8000	504,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
28	An	Pjerje asfalti ne te dy anet	ml	105	500	52,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
29	3.210	Shtrese cakulli e mbeturine kave t=15 cm perthapur e ngjeshur me makineri	m2	14	900	12,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
30	3.212	Shtrese cakulli t=10/15 cm makadam perthapur e ngjeshur me makineri	m2	14	600	8,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
31	3.212/c	Shtrese stabilizant t= 15 cm	m2	14	600	8,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
32	3.212/b	Shtrese stabilizant t= 10 cm	m2	10	450	4,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
33	3.222/2	Shtrese binderi me granil gure kave 6 cm me makineri	m2	6	1700	10,200.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
34	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave 4 cm me makineri	m2	4	1400	5,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
35	3.238	Beton M 100 per veshje tubacioni	m ³	8	8000	64,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
36	An	Prishje trotuar me pllaka	m2	235	250	58,750.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
37	An-49(M2)	Prishje struktura betoni	m3	7	3500	24,500.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
38	2.288	Nderfirm trotuar me pllaka betoni t=6cm	m2	235	2000	470,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
39	An 56 (M3)	F.v tub metalik Ø 140 mm	ml	180	1700	306,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
40	An	F.v ndricues muror LED 24 w per fasada	cope	127	9000	1,143,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
41	An	Kabell Cu 5x2.5 mm2 (per fasadat)	ml	1400	240	336,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
42	An	F.v automat 6A	cope	25	600	15,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
43	2.487	F.v kuti derivacioni plastike	cope	25	120	3,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
44	480/5	F.V.tubo plastike Ø32	ml	1300	200	260,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
45	An	F.v projektore LED 10 w te inkastruar ne cdo peme ne trotuar	cope	166	16400	2,722,400.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
46	4.141/a7.0	F.v shirit sinjalizimi	ml	1600	10	16,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
				SHUMA 7		15,826,390.0	
				SHUMA 7		15,826,390.0	

PUNIME SHIPIMI PUSESH

		PUNIME RRUGORE					
1	3.241	Cimentim Kollone anesore Beton M-150	m3	0.58	10000	5,800.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
2	An	Shpim pusi me diameter Ø=205mm	ml	40	1200	48,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
3	2.491/i	F.V.Tubo PE Ø=125mm =Ø-8.6mm PN 10	ml	40	2000	80,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
4	An	Mbushje tringut anesor me granil	m3	1.018	1200	1,221.6	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
5		Pompe siperfaqsores	cope	3	42000	126,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
				SHUMA 8		261,021.6	
				SHUMA 8		261,021.6	

PUNIME HIDROTEKNIKE

1	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 075m2	m3	11	700	7,700.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
2	2.491/a	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t=2.0mm, PN 10	ml	271	160	43,360.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
3	2.491/b	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t= 2.0 mm, PN 10	ml	195	180	35,100.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk



4	2.491/c	F.V Tuba e rakordeni ujesjellesi PE d=32mm, t= 2.4 mm, PN 10	ml	8	200	1,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
5	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	cope	2	800	1,600.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
6	2.494/2	F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	cope	4	1000	4,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
7	An.1	F.V Sprucator vaditje per lulishtet	cope	64	1500	96,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
8	3.An/pp	FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 RIC 1084+1086	cope	3	3400	10,200.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
9	An - 23	Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	31	22000	682,000.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
10	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	cope	321	1043	334,803.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
11	2.209/a	Ulluk shkarkimi vertikal me PVC Ø 120mm	ml	4470	330	1,475,100.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
12	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto den 5.0 km	m3	11	270	2,970.0	shoqeria "G.P.G. Company".shpk
				SHUMA 9		2,694,433.0	
				SHUMA 9		2,694,433.0	
				SHUMA 1+2+3+4+5+6+7+8+9		165,025,674.6	
				Fond rezerve 3 %		4,950,770.2	
				Shuma		169,976,444.8	
				T.v.sh 20 %		33,995,289.0	
				Totali		203,971,733.8	

shoqeria "MODESTE" shpk

administrator

Xhentil Kofobelli



shoqeria "G.P.G Company" shpk

administrator

Paqsoz Buzi

